

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 2000/03

UNMIK/DIR/2000/03

7 shkurt 2000

ZBATIMI I RREGULLORES NR. 1999/13 MBI LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE JOBANKARE NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë atij me nenin 5 të Rregullores nr. 1999/13 të datës 16 tetor 1999 lidhur me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që ka të bëjë me dhënien e lejes institucioneve mikrofinanciare jobankare në Kosovë, dhe duke marrë parasysh nenin 2 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21 të datës 15 nëntor 1999 mbi licencimin e bankave, mbikëqyrjen dhe rregullimin,

Jep këtë udhëzim administrativ:

Neni 1

Delegimi i kompetencës

Organi i Kosovës për Banka dhe Pagesa do t'i shqyrtojë kërkesat për dhënien e lejeve institucioneve mikrofinanciare jobankare që dëshirojnë të veprojnë në Kosovë dhe do ta mbikëqyrë e rregullojë aktivitetin e tyre.

Neni 2

Zbatimi

Organi i Kosovës për Banka dhe Pagesa mund të lëshojë rregulla dhe urdhëra lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrative hyn në fuqi më 7 shkurt 2000.

Bernard Kouchner
Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm